



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2019

**V E N D I M**

**Nr. 23, Datë 07/02/2019**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 136, datë 12.09.2018, e Z. D.N., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjeve politike”<sup>1</sup>, nga ana e Albpetrol sh.a.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur saj, rezulton se ankuesi D.N., i lindur në datën 08.04.1961, në Kuqar, Fier, punon pranë Albpetrol sh.a., që prej datës 23.03.1984. Nga muaji nëntor i vitit 2011 e në vijim ka punuar në pozicionin “*roje objekti*”, pranë Qendrës së Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos (ish- Q.A.R. Patos). Nëpërmjet shkresës nr. 6494, datë 24.07.2018, të Albpetrol sh.a., ankuesi është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me këtë shoqëri, pasi në kuadër të ristrukturimit të Albpetrol sh.a. dhe referuar sistemit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer për punonjësit e

---

<sup>1</sup> Referuar kartës së anëtarësisë nr. 24463, lëshuar në datën 07.06.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim;

<sup>2</sup>Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Q.A.K.P. Patos, rezulton se ankuesi nuk plotëson kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

Z. D.N. ka paraqitur ankesën nr. 6626, datë 26.07.2018, pranë Albpetrol sh.a., ku konteston çështjen e pushimit të tij nga puna. Në përgjigje të ankesës së tij, Albpetrol sh.a. ka dërguar shkresën nr. 7155/1, datë 03.08.2018, nëpërmjet së cilës e informon ankuesin, se Komisioni i Vlerësimit të Ankesave i ngritur pranë kësaj shoqërie ka kryer verifikimet përkatëse, nga ku ka rezultuar se procedura e ndjekur në Q.A.K.P. Patos ka qenë konform legjislacionit në fuqi dhe urdhërave të dalë në zbatim të procesit të ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol. Në shkresë theksohet fakti se pozicioni i punës “roje objekti” që mban ankuesi është shkurtuar, si dhe ankuesi rezulton me masë disiplinore “vërejtje me shkrim”. Për sa më sipër, shoqëria Albpetrol sh.a. ka marrë në konsideratë kualifikimin e Z. D.N., por zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka qenë e pashmangshme për shkak të shkurtimit të pozicionit të punës, si dhe performancës së tij të dobët në punë.

Për sa më sipër, Z. D.N. pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar i forcës politike Lëvizja Socialiste për Integrim. Në këtë kontekst, ai sjell në vëmendjen e KMD-së, rastin kur për të është dhënë Vendimi nr. 415, datë 11.09.2017, i Administratorit të Albpetrol për zgjidhjen e menjëherëshme e të justifikuar të kontratës së punës, e në vijim, pasi Z. D.N. ka paraqitur kërkesëpadi në gjykatë për këtë çështje, Albpetrol sh.a. e ka revokuar vendimin e mësipërm, nëpërmjet vendimit nr. 460, datë 13.10.2017, të Administratorit të shoqërisë dhe ankuesi është rikthyer në punë.

### **I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

1. Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 136, datë 12.09.2018, e Z. D.N. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
2. Mbështetur në nenin 33, pika 7<sup>3</sup>, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Albpetrol sh.a. dhe për dijeni

---

<sup>3</sup> Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin

ankuesit, me shkresën nr. 1233/1, datë 14.09.2018, ku kërkohet informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesi, si dhe iu kërkua të dërgoheshin aktet e poshtëcituar:

- Kopje e kontratës së punës së ankuesit me Albpetrol sh.a.;
- Kopje e librezës së punës së ankuesit;
- Informacion, nëse ndaj Z. D.N. janë marrë masa disiplinore, gjatë kohës që ka punuar pranë Albpetrol sh.a. Nëse po, të dërgohet akti përkatës administrativ;
- Vlerësime për punën e kryer nga ankuesi ndër vite pranë Albpetrol sh.a.;
- Kopje e Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës, të Albpetrol sh.a.;
- Kopje e Vendimit nr. 496/10 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, në të cilin është parashikuar ristrukturimi i shoqërisë Albpetrol;
- Kopje e Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, dhe Urdhërit nr. 51, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a.;
- Kopje e strukturës aktuale dhe strukturës së mëparshme të Q.A.K.P. Patos;
- Numri i rojeve të objektit, pranë Q.A.K.P. Patos dhe sa prej tyre janë pushuar nga puna në kuadër të zbatimit të pushimit kolektiv nga puna;
- Numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.A.K.P. Patos që janë pushuar nga puna, në kuadër të ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol;
- Numri i emërimeve të reja të kryera pranë Q.A.K.P. Patos gjatë periudhës janar-korrik 2018.
- Informacion mbi punonjësit e punësuar përgjatë periudhës janar-korrik 2018 pranë Q.A.K.P. Patos, që i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 1233/1, datë 14.09.2018, së Komisionerit, Administratori i Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 1233/1, datë 31.10.2018<sup>4</sup>, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Z. D.N. është punonjës i Albpetrol sh.a. prej datës 23.03.1984. Gjatë marrëdhënieve të punës në Shoqërinë “Albpetrol” sh.a., ankuesi ka punuar fillimisht përgjatë periudhës kohore 23.03.1984 – 01.11.2011 në pozicionin “*operator prodhimi*” dhe më pas nga data 01.11.2011 e në vijim ka punuar në pozicionin “*roje objekti*”.

Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të “Albpetrol” sh.a. dhe Vendimit nr. 496/10, datë

---

*parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.*

<sup>4</sup>Shkresa i është dërguar për dijëni edhe ankuesit.

25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria “Albpetrol” sh.a. është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye, kjo shoqëri ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv duke njoftuar punonjësit që preken nga ky proces. Në rastin konkret, në Qendrën e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos (ish-Q.A.R. Patos) është kryer një riorganizimim tërësor duke shkurtuar disa vende pune si: përgjegjës turni, magazinier, inxhinier zone, si dhe roje objekti. Për këtë arsye, punonjësit e Q.A.K.P. Patos i janë nënshtruar procedimit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer nga komiteti përkatës i ngritur në bazë të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të shoqërisë. Sipas strukturës së re, organizative të miratuar për Qendrën e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos janë shkurtuar gjithësej 54 pozicione pune “roje objekti”. Numri i pozicioneve të punës “roje objekti” në Qendrën e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos përpara ristrukturimit të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. ishte **171 vende pune**, ndërkohë që, pas procesit të ristrukturimit organizativ, numri rojeve është reduktuar në **117 vende pune**, emërtimi i të cilave është konvertuar në “Kontrollor të Pajisjeve të Naftës”.

Për të kryer një proces sa më transparent, Shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka aplikuar një sistem përzgjedhjeje me anë të vlerësimit me pikë, mbi bazën e së cilit janë përzgjedhur se do të qendrojnë në punë ata punonjës që janë vlerësuar me më shumë pikë. Kriteret, mbi bazën e së cilëve u krye vlerësimi me pikë ishin arsimi, kualifikimi, vjetërsia, etj. Për të gjitha këto procedura është arritur një marrëveshje e përbashkët ndërmjet Shoqërisë “Albpetrol” sh.a., në cilësinë e punëdhënësit dhe Sindikatës së Re të Naftëtarëve në cilësinë e subjektit, që mbron interesat e punëmarrësve. Kjo Sindikatë ka nënshkruar edhe Kontratën Kolektive të punës, me Albpetrol sh.a.

Referuar procesit të vlerësimit dhe pikëzimit të kryer për punonjësit e Qendrës së Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos, rezulton se Z. D.N. nuk plotëson kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënies së punës. Për këtë arsye është njoftuar rregullisht me shkresën nr. 6494, datë 24.07.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të shkurtimit të vendit të punës, sipas nenit 143 dhe 148 të Kodit të Punës. Ndërprerja e marrëdhënieve të punës me Z. D.N. nuk vlerësohet si pushim individual, por si pushim kolektiv për shkak të punonjësve që janë përfshirë në këtë proces, në referencë të nenit 184, pika 1, të Kodit të Punës. Kjo do të thotë se marrëdhënia punëdhënës-punëmarrës, pra raporti midis shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe Z. D.N. nuk është aspak individual dhe i lidhur me pretendimin e tij se është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të bindjeve politike. Përzgjedhja e punonjësve, të cilët do të vazhdojnë marrëdhëniet e punës dhe të atyre që do t’ju ndërpriten marrëdhëniet e punës nuk ka patur asnjë kriter diskriminues, por ashtu si u bë e qartë dhe më sipër është kryer mbi bazën e pikëzimit nga një Komision i Posaçëm.

Proçesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimit të fuqisë punëtore është një proces dinamik, që ka prekur punonjës të profesioneve, moshave dhe vjetërsive të ndryshme në punë. Në total, nga proçesi i ristrukturimit të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. janë prekur rreth 450 punonjës, të cilët janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të shoqërisë.

Për sa i përket pretendimit të ankuesit se është diskriminuar për shkak të bindjes politike, pasi është anëtar i LSI, Albpetrol sh.a. shprehet se ky pretendim është i pabazuar, pasi kjo shoqëri nuk disponon të dhëna mbi përkatësinë politike të punonjësve të saj, por vetëm të dhënat bazë të punonjësve, për të cilat është marrë edhe miratimi i tyre me shkrim, sipas formularit përkatës, si dhe në përputhje me kërkesat bazë të legjislacionit në fuqi. Në asnjë shkresë apo praktikë të punëdhënësit “Albpetrol” sh.a. nuk është përmendur përkatësia politike e punonjësit. Në shoqërinë Albpetrol sh.a. janë paraqitur ankesa nga punonjës të prekur nga ristrukturimi, të cilët pretendojnë përkatësinë dhe bindje të ndryshme politike, fakt i cili hedh poshtë pretendimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike.

Albpetrol sh.a. thekson faktin se ankuesi ka barrën e provës të vërtetë të shkresërisht se punëdhënësi ka qenë zyrtarisht në dijeni të përkatësisë politike të ankuesit. Albpetrol shprehet se ekziston mundësia të diskriminosh dikë për bindjet politike, vetëm kur ke patur dijeni mbi përkatësinë e tij në një forcë politike apo mbi këto bindje politike. Nga verifikimet e kryera në dosjen e ankuesit D.N. nuk rezultojnë asnjë e dhënë mbi bindjet e tij, politike.

Lidhur me çështjen e ngritur nga ankuesi për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së punës nëpërmjet Vendimit nr. 415, datë 11.09.2017, Albpetrol sh.a. sqaron se mbështetur në shkresën nr. 5523, datë 18.08.2017 e Q.A.R. Patos, ku ankuesi ushtronte detyrën, është filluar proçedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, për shkak të mungesës në vendin e punës. Për këtë shkak, me Vendimin nr. 415, datë 11.09.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a. janë zgjidhur marrëdhëniet e punës me Z. D.N.. Pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, Z. D.N. ka paraqitur kërkesën e tij për rikthim në vendin e punës, pasi ka pretenduar se ka njoftuar Shefin e Zonës, për fillimin e lejes vjetore, për shkak se ka patur qëllim të largohej jashtë vendit për arsye familjare. Në shqyrtim të kërkesës së paraqitur, Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka rezultuar se Shefi i Zonës është njoftuar nga Z. D.N. për fillimin e lejes vjetore nga ana e tij nga data 03.08.2017, deri në datën 16.08.2017. Shefi i Zonës ka pranuar që është njoftuar nga Z. D.N., por nuk ka kryer pasqyrimet përkatëse në listëprezencën mujore, për shkak se ankuesi nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim për miratimin e lejes vjetore nga administrata e e Q.A.R. Patos, por vetëm ka njoftuar verbalisht Shefin e Zonës. Duke marrë në konsideratë kërkesën e paraqitur nga Z. D.N., si dhe arsyet familjare që e detyruan të largohet urgjent jashtë vendit, me Vendimin nr. 460, datë 13.10.2017, Administratori i Albpetrol sh.a. ka

revokuar Vendimin nr. 415, datë 11.09.2017 dhe ka vendosur rikthimin në punë të tij në pozicionin e punës “roje objekti” pranë Q.A.R., Patos.

Ndër të tjera, Albpetrol sh.a. e bën me dije Komisionerin se nga momenti i punësimit e në vijim, ndaj Z. D.N. janë dhënë dy masa disiplinore “vërejtje me shkrim” për shkak të mosrespektimit të kushteve të kontratës individuale të punës.

- II.** Në vijim të ndjekjes së procedurave hetimore mbi ankesën nr. 136, datë 12.09.2018, e Z. D.N., Komisioneri vendosi të realizojë një seancë dëgjimore në datën **23.11.2018, ora 13:00**. Palët u njoftuan për pjesëmarrje në seancë dëgjimore, nëpërmjet shkresës nr. 1233/2, datë 13.11.2018, së Komisionerit. Në shkresën e sipërpërmendur, Albpetrol sh.a. iu ku kërkuar që përfaqësuesit e saj të depozitonin në seancë dëgjimore, procesverbalet e Komisionit të Vlerësimit, ku të reflektohej vlerësimi me pikëzime të gjithë punonjësve në pozicionin “roje” pranë Q.A.K.P. Patos.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 23.11.2018, u paraqit ankuesi dhe përfaqësuesi i Albpetrol sh.a., Z. A. V. Ky i fundit depozitoi Autorizimin nr. 11612 Prot., datë 22.11.2018, e Administratorit të Albpetrol sh.a., nëpërmjet së cilit autorizohet për përfaqësim të kësaj shoqërie. Ankuesi parashtrori edhe një herë pretendimet e tij duke u shprehur se kishte një përvojë pune shumëvjeçare pranë Albpetrol sh.a., fillimisht në pozicionin “operator prodhimi” e në vijim në pozicionin roje objekti. Ankuesi u shpreh se nëpërmjet Vendimin nr. 415, datë 11.09.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., marrëdhëniet e tij të punës me këtë shoqëri ishin zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme, pasi ai kishte marrë një pjesë të lejes së tij vjetore, duke njoftuar verbalisht Shefin e Zonës. Ky i fundit nuk e kishte reflektuar një fakt të tillë në listëprezencën mujore të Q.A.K.P. Patos dhe si rrjedhim mungesat e Z. D.N. ishin konsideruar të paarsyeshme dhe Administratori i Albpetrol sh.a., kishte zgjidhur marrëdhëniet e punës me të. Përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. u shpreh se në vijim, pas depozitimit të një kërkesë me shkrim nga ana e ankuesit pranë Albpetrol sh.a., administrata e Albpetrol sh.a. kishte kryer verifikimet përkatëse me shefin e zonës pranë Q.A.K.P. Patos, nga ku kishte rezultuar se atë periudhë kohore ankuesi kishte qenë me leje vjetore, por të cilën nuk e kishte kërkuar nëpërmjet një kërkesë me shkrim, por vetëm verbalisht nga shefi i zonës. Në këto kushte, Administratori i Albpetrol sh.a. kishte revokuar Vendimin e sipërpërmendur, nëpërmjet Vendimit nr. 460, datë 13.10.2017 dhe ankuesi ishte rikthyer në punë.

Ankuesi u shpreh se ishte i padrejtë fakti që ai ishte përfshirë në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a. dhe një gjë e tillë kishte ndodhur për shkak të bindjeve të tij politike, pasi ai është anëtar i forcës politike LSI. Ndërkohë që, përfaqësuesi i Albpetrol sh.a. u shpreh se në këtë pushim kolektiv ishin përfshirë 96 punonjës të Q.A.K.P. Patos. Nga këta, 57 pozicione pune

ishin roje, sikurse ankuesi. Ai theksoi faktin se nga 171 pozicione rojesh, aktualisht vetëm 117 të tillë bëjnë pjesë në strukturën e re organizative të Q.A.K.P. Patos. Komisioni i Vlerësimit ka marrë në shqyrtim dokumentacionin e punonjësve që kanë punuar në këtë pozicion pune dhe në bazë të vlerësimit me pikëzim është vendosur që ankuesi t'i nënshtrohet pushimit kolektiv, sikurse 56 punonjës të tjerë që kanë punuar në këtë pozicion pune. Përfaqësuesi i ALbpetrol sh.a. theksoi faktin se Z. D.N. ishte cilësuar me performancë të dobët në punë dhe kishte marrë disa masa disiplinore, të cilat kishin ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përfshirjen e tij në pushimin kolektiv.

1. Në vijim të seancës dëgjimore, Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 842, datë 28.01.2019, ku parashtrihen prapësimet e kësaj shoqërie, ndaj pretendimeve të ankuesit D.N.. Bashkelidhur shkresës u dërguan masat disiplinore të dhëna për Z.D.N., si dhe vlerësimet me pikëzim, për të gjithë punonjësit në pozicionin “roje”, Sektori i Dytë, Zona e Dytë, pranë Q.A.K.P. Patos.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.**

Z. D.N. ka punuar pranë Albpetrol sh.a. prej datës 23.03.1984, në pozicionin e punës “*roje objekti*”, pranë Qendrës së Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos (ish-Q.A.R. Patos). Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës në Shoqërinë “Albpetrol” sh.a., fillimisht ankuesi ka punuar përgjatë periudhës kohore 23.03.1984 – 01.11.2011 në pozicionin “*operator prodhimi*” dhe më pas nga data 01.11.2011 e në vijim ka punuar në pozicionin “*roje objekti*” pranë Q.A.K.P. Patos. Z. D.N. pretendon se është diskriminuar për shkak të bindjes së tij politike, nga ana e Albpetrol sh.a., pasi është përfshirë në pushimin kolektiv që kjo shoqëri ka ndërmarrë në kuadër të riskrukturimit të saj. Referuar kartës së anëtarësisë nr. 24463, lëshuar në datën 07.06.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim, ankuesi rezulton të jetë anëtar i kësaj force politike.

**A/1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit nga Albpetrol sh.a., si pasojë e zgjidhjes së kontratës së punës së tij me këtë shoqëri, nëpërmjet Vendimit nr. 415, datë 11.09.2017, të Administratorit të kësaj shoqërie.**

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 136, datë 12.09.2018, së Z. D.N. rezulton se nëpërmjet Vendimit nr. 415, datë 11.09.2019, të Administratorit të kësaj shoqërie, kontrata e punës ndërmjet ankuesit dhe Albpetrol sh.a. është zgjidhur në mënyrë të menjëherëshme dhe të justifikuar. Referuar pikës 1, të këtij Vendimi citohet: *“Zgjidhjen e menjëherëshme të justifikuar të kontratës së punës me Z. D.N. për arsyet që janë parashtruar dhe në takimin e datës 04.09.2017, në të cilin Z. D.N. u paraqit”*.

Nga shqyrtimi i akteve të depozituara pranë KMD-së rezulton se vendimi i sipërpërmendur është marrë mbështetur në shkresën nr. 466, datë 18.08.2017, *“Propozim për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës individuale të punës”*, të Drejtorit të Q.A.R. Patos dhe Përgjegjësit të Zyrës së Administratës dhe Personelit të kësaj qendre drejtuar Albpetrol sh.a., ku theksohet fakti se: *“Z. Durim Sali D.N. me detyrë “roje Objekti”, zona e dytë, sektori i dytë në Q.A.R. patos, sipas listëprezencës së paraqitur nga Përgjegjësi i Sektorit të II-të, për periudhën 01-08.08.2017 rezulton me mungesa në punë nga datat 02-16.08.2017 (në total 14 ditë pune) duke mos paraqitur asnjë shkak ligjor të justifikuar.....Ju propozojmë që Z. Durim Sali D.N. t'i zgjidhet kontrata e punës në mënyrë të menjëherëshme për arsye të mosparaqitjes në detyrë dhe zbatimin konform të rregullave të punës, sipas nenit 15, pika 15.1.9 të Kontratës Individuale të Punës”*.

Referuar Proçesverbalit nr. 5802, datë 04.09.2017, të takimit të realizuar ndërmjet ankuesit dhe përfaqësuesve të strukturave të Albpetrol sh.a. rezulton se: *“Z. D.N. nuk është paraqitur në vendin e punës pranë Q.A.R. patos nga datat 02 Gusht 2017 deri në datën 16 gusht 2017 (në total 14 ditë pune), sipas materialit të paraqitur nga Qendra Q.A.R. Patos Nr. 5523 prot., datë 18.08.2017 duke mos paraqitur asnjë shkak të arsyeshem. Për këto mungesa, Z. D.N. nuk ka paraqitur asnjë shkak të arsyeshem”*. Në këtë takim, ankuesi është shprehur se për datat e sipërpërmendura ka kërkuar (verbalisht) lejen e zakonshme, për arsye se ka patur djalën në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe i duhet të udhëtonte jashtë vendit. Për këtë arsye ai shprehet se ka biseduar me Përgjegjësin e Burimeve Njerëzore, i cili e kishte rekomanduar të fliste me Shefin e tij të Zonës, që i kishte dhënë leje. Ankuesi thekson faktin se ndërkohë që ishte me leje, ishte njoftuar për t'u kthyer në punë, pasi nuk i ishte miratuar leja vjetore. Z. D.N. ishte kthyer në detyrë, në datën 11.08.2017, ndërkohë që ishte informuar, se ditët për të cilat i ishte dhënë leje vjetore, i ishin shënuar mungesë në listëprezencën e muajit gusht 2017. Në vijim, ndaj ankuesit



është dhënë Vendimi nr. 415, datë 11.09.2017, nëpërmjet së cilit i zgjidhej kontrata e punës në mënyrë të menjëherëshme, për shkaqe të justifikuara.

Ankuesi ka depozituar në vijim pranë Albpetrol sh.a. një kërkesë me shkrim, datë 19.09.2017, ku shpreh refuzimin për të pranuar vendimmarrjen e Administratorit të Albpetrol sh.a., për zgjidhjen të menjëherëshme të marrëdhënieve të punës, duke theksuar faktin gjatë datave 02-16.08.2017, ai ka qenë me leje vjetore dhe nuk ka kryer mungesa pa arsye. Njëkohësisht, ankuesi ka depozituar padi pranë gjykatës së rrethit gjyqësor Fier, kundër Albpetrol sh.a.

Në vijim, Drejtori i Burimeve Njerëzore të Albpetrol sh.a. i është drejtuar Z. E. P., Administrator i Albpetrol sh.a., me shkresën nr. 6835 Prot., datë 13.10.2017, *“Propozim për revokimin e Vendimit nr. 415, datë 11.09.2017”*, ku përmendet fakti se ankuesi pretendon se ka njoftuar Shefin e Zonës për fillimin e lejes së tij vjetore, të cilën e ka kërkuar, pasi do të largohej për arsye familjare jashtë vendit. Në shkresë theksohet se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka kryer verifikimet përkatëse, nga ku ka rezultuar se Shefi i Zonës është njoftuar nga Z. D.N. për fillimin e lejes vjetore nga ana e tij nga data 03.08.2017, deri në datën 16.08.2017. Shefi i Zonës ka pranuar që është njoftuar nga Z. D.N., por nuk ka kryer pasqyrimet përkatëse, për shkak se nuk është kryer miratimi i lejes nga administrata e Q.A.R. Patos. Në shkresën e mësipërme citohet: *“Duke qenë se jemi në kushtet ku Z. D.N. ka njoftuar për fillimin e lejes vjetore, por nuk ka mundur të marrë miratimin me shkrim të saj, për shkak se është larguar me urgjencë jashtë vendit për arsye familjare, ne propozojmë revokimin e vendimit nr. 415, datë 11.09.2017, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës dhe rikthimin e Z. D.N. në vendin e tij të punës Roje pranë Q.A.R. Patos të shoqërisë Albpetrol sh.a.”*

Në vijim të shkresës së mësipërme, nëpërmjet Vendimit nr. 460, datë 13.10.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a. është revokuar Vendimi nr. 415, datë 11.09.2017, të Administratorit të kësaj shoqërie. Në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi përcaktohet: *“1.Revokimin e vendimit nr. 415, datë 11.09.2017 dhe rikthimin e Z. D.N. në vendin e punës Roje pranë Q.A.R. Patos të shoqërisë Albpetrol sh.a.; 2. Marrëdhëniet e punës dhe ato financiare fillojnë më datë 16.10.2017”*.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se Z. D.N. nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim për të kërkuar lejen e tij vjetore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë Q.A.R. Patos, por duke gjykuar se rasti i tij ishte i veçantë, pasi leja vjetore i nevojitej me urgjencë, për arsye shëndetësore të familjarit të tij dhe ai ka njoftuar verbalisht eprorët e tij, një fakt i tillë duhej mbajtur parasysh nga personat përgjegjës të Albpetrol sh.a. Në nenin 93, pika 1, të Kodit të Punës, si dhe pikën 9, të Kontratës Individuale të Punës, së lidhur me Albpetrol sh.a. përcaktohet

se: *“Punëdhënësi duke mbajtur parasysh dëshirën e punëmarrësit përcakton datën e fillimit të pushimeve vjetore të paguara. Data e fillimit të pushimeve vjetore i njoftohet punëmarrësit të paktën 30 ditë përpara.”* Kjo presupozon që leja vjetore planifikohet në kohën e duhur dhe punëdhënësi e miraton atë dhe njofton punëmarrësin të paktën 30 ditë para ditës së fillimit të saj.

Vendimi nr. 415, datë 11.09.2019, i Administratorit të Albpetrol sh.a. ka rezultuar të jetë marrë, pa kryer verifikimet e nevojshme për sqarimin e situatës konkrete, para se të zgjidheshin marrëdhëniet e punës me ankuesin, rasti i së cilit ishte specifik. Por, në kushtet kur ky vendim është revokuar, reflekton vullnetin e Albpetrol sh.a. për rivënien e së drejtës së shkelur, të punonjësit të kësaj shoqërie. Nëpërmjet revokimit të Vendimit nr. 415, datë 11.09.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., ankuesi është rikthyer në detyrën e mëparëshme, përkatësisht në pozicionin “roje” pranë Q.A.R Patos. Ankesa e Z. D.N. pranë Komisionerit është depozituar pas revokimit të Vendimit nr. 415, datë 11.09.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a., pra në një moment kur e drejta e shkelur e punonjësit është rivënë sërish nga kjo shoqëri.

Referuar nenit 7, pika 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vlerëson se për rastin konkret, ankuesi nuk është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a.

**A/2. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankuesit nga Albpetrol sh.a., si pasojë e përfshirjes në pushimin kolektiv të zbatuar nga kjo shoqëri në kuadër të ristrukturimit të saj.**

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës nr. 136, datë 12.09.2018, e Z. D.N., rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a. është duke zbatuar një proces ristrukturimi, si rrjedhim i së cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1. Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë

nënshtuar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë *“Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”* parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njësive të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur, fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë që të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtoheshin punonjësit e kësaj shoqërie,

Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., kriteret, të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patentë specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës.

Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t’i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e Komisioneve të Vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a., “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.A.K.P., Patos, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë është reduktuar<sup>5</sup>, në krahasim me numrin e mëparshëm<sup>6</sup> të punonjësve pranë kësaj qendre. Në zbatim të nenit 147, pika 5, të Kodit të Punës, **96 punonjës të Q.A.K.P., Patos** janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si pasojë e pushimit kolektiv. Z. D.N. punonte në pozicionin e punës “*roje objekti*”, pranë kësaj Qendre. Numri i pozicioneve të punës “*roje objekti*” në Qendrën e Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos përpara ristrukturimit të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. ishte **171 vende pune**, ndërkohë që, pas procesit të ristrukturimit organizativ, numri rojeve është reduktuar në **117 vende pune**, emërtimi i të cilave është konvertuar në “*Kontrollor të Pajisjeve të Naftës*”. Për sa më sipër, rezulton se **54 punonjës**, që kanë punuar në pozicionin “roje” pranë kësaj qendre i janë nënshtruar pushimit kolektiv.

Në kushtet kur, nga 171 punonjës, punonin në pozicionin “roje objekti” pranë Q.A.R. Patos, 54 prej tyre do të shkurtoheshin, Komisioni i Vlerësimit, i ngritur pranë kësaj qendre, në bazë të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., kreu vlerësimin e tyre me

<sup>5</sup>Referuar shkresës nr. 5533/6, datë 02.07.2018, së Administratorit të Albpetrol sh.a. drejtuar Q.A.K.P. Patos, bashkëlidhur së cilës ndodhet Struktura Organizative e Qendrës së Administrimit dhe Kontrollit të Pronës Patos.

<sup>6</sup> Referuar strukturës paraardhëse të Q.A.K.P. Patos.

pikëzim, sipas kriterëve të miratuara në Akt-marrëveshjen me Sindikatën e Naftëtarëve, ndryshuar me Shtojcën nr. 1, pjesë integrale e këtij Urdhëri. Referuar procesverbalit të vlerësimit me pikëzim të Z. D.N. rezulton se ai është vlerësuar me 55 pikë, nga të cilat 35 pikë i përfiton nga arsimi i tij, 20 pikë i përfiton falë eksperiencës së tij në punë, pasi ka punuar 38.9 vite në industrinë e naftës dhe për kualifikimin profesional është vlerësuar me 0 pikë.

Referuar Dispozitës së Fundit të Shtojcës 1, të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a. përcaktohet: *“Në kryerjen e procesit të vlerësimit dhe pikëzimit, Komisioni për të përzgjedhur punonjësit që preken nga procesi i ristrukturimit organizativ dhe të fuqisë punëtore, pavarësisht klasifikimit të mësipërm, do të marrë në konsideratë edhe treguesit e mëposhtëm të performancës në punë:*

- *Masat disiplinore që rezultojnë për atë punonjës;*
- *Vlerësimi i treguesve në punë.”*

Referuar procesverbalit të vlerësimit me pikëzim, konstatohet se performanca e tij në punë cilësohet e dobët, pasi ndaj ankuesit janë dhënë disa masa disiplinore, 2 prej të cilave në vitin 2017 dhe disa masa disiplinore në vitin 2014, ku këto të fundit janë parashkruar. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se nëpërmjet shkresës nr. 475/5, datë 28.08.2017, së Drejtorit të QAR Patos, fillimisht Z. D.N. i është dhënë masa disiplinore *“vërejtje me shkrim”* me motivacion *“shkelje e rregullave të punës, pasi në mënyrë të përsëritur gjatë kohës së punës nuk ka ndezur GPS Personal”*, veprim që përbën shkelje të disiplinës në punë. Në vijim, ankuesit i është dhënë sërish *“vërejtje me shkrim”*, nëpërmjet shkresës nr. 498/2, datë 12.09.2017, të Drejtorit të Q.A.R. Patos, me motivacion *“mosrespektim i rregullave gjatë shërbimit roje, në lidhje me pajisjen GPS nr. 106., të cilën nuk e ka vendosur në funksionim”*.

Njëkohësisht, Albpetrol sh.a. ka depozituar në cilësinë e provës shkresën nr. 1201, datë 29.10.2018, *“Mbi performancën në punë të Z. D.N.”*. Shkresa e sipërpërmendur është e nënshkruar nga Drejtori i Q.A.K.P. Patos dhe Përgjegjësi i Sektorit të Dytë. Në këtë shkresë citohet: *“Që nga viti 2013 Z. D.N. ka qenë problematik për disiplinën në punë. Për shkak të disiplinës së dobët gjatë kohës që punonte në sektorin e parë dhe për t'i krijuar lehtësi u transferua në sektorin e dytë të qendrës, ku përsëri vazhdoi me performancë problematike. Z. D.N. edhe në komunikim ka qenë i vështirë se kundërshtonte çdo rast që konstatohej keq në punë. Është konstatuar vijimësisht mosmbajtje të uniformës në punë si largime nga vendi i punës, gjetje në lokal, mosmbajtje të Gps. Personal etj. Për këto shkelje i është tërhequr vëmendja dhe për shkak të ripërsëritjes së tyre me vendime të drejtorit të qendrës i janë dhënë masa disiplinore...”*

Referuar akteve të depozituara nga ana e Albpetrol sh.a. rezulton se edhe punonjës të tjerë që kanë punuar në pozicionin “roje” pranë Q.A.K.P. Patos, e kanë patur vlerësim me pikë të barabarta me ankuesin, i janë nënshtruar pushimit kolektiv.

Pas përfundimit të procesit të vlerësimit me pikëzim, Albpetrol sh.a. e ka njoftuar Z. D.N., me anë të shkresës nr. 6494, datë 24.07.2018, lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, Z. D.N. ka dërguar ankimin e tij nr. 6626, datë 03.08.2018, drejtuar Administratorit të Shoqërisë, ku shprehet se e konsideron të padrejtë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me këtë Shoqëri. Në përgjigje të ankesës së Z. D.N., Albpetrol sh.a dërgoi shkresën nr. 7155/1, datë 03.08.2018, nëpërmjet së cilës ankuesi sqarohet lidhur me faktin se, ai i është nënshtruar pushimit kolektiv nga puna për shkak të ristrukturimit të shoqërisë, pasi pozicioni i tij i punës është shkurtuar. Në shkresë citohet: *“Shoqëria “Albpetrol” sh.a. ka marrë në konsideratë kualifikimin tuaj, por zgjidhja e marrëdhënieve të punës me Ju, është e pashmangëshme për shkak të shkurtimit të pozicionit tuaj të punës dhe performancës suaj të dobët”*.

Në referencë të shkresës nr. 5537, datë 02.07.2018, së Albpetrol sh.a., rezulton se në çdo Komision Vlerësimi të ngritur pranë çdo qendre prodhimi apo shërbimi, në varësi të Albpetrol sh.a., bën pjesë në cilësinë e anëtarit edhe një përfaqësues i Sindikatës së Naftëtarëve, e cila është përfaqësuese e punonjësve të Albpetrol sh.a. Kjo shërben si një garanci për të gjitha veprimet e kryera nga Komisionet përkatëse, pasi përfaqësuesit e Sindikatës mbrojnë interesat e punonjësve të Albpetrol sh.a.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se shkak për skualifikimin e Z. D.N., gjatë procesit të vlerësimit me pikëzim nga Komisioni i Vlerësimit, pranë Q.A.K.P. Patos, janë 2 (dy) masat disiplinore që atij i janë dhënë nga eprorët e tij. Si pasojë e këtij skualifikimi, ankuesi u përfshi në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a., sikurse edhe 54 punonjës të tjerë të kësaj qendre, që kishin punuar në pozicion të njëjtë me ankuesin.

Në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

## **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të Z. D.N., nga ana e Albpetrol sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankimi, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Robert GAJDA**

**KOMISIONERI**

Fusha – punësim  
Shkak – bindja politike